

	INFRAKOS SH.A. INFRAKOS D.D. INFRAKOS J.S.C.
2	
Nr.No.Br.	2/71
Dt.	12.09.2023
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje	



12/09/2023

Në bazë të nenit 25, pika (h), ndërlidhur me nenin 21 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, (Ligji nr.03/L-087, datë:13.06.2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 datë: 20.04.2012 dhe vendimit të datës 27.07.2023 nr.prot.2/56, Komisioni i Auditimit në takimin e mbajtur me datën 12.09.2023 mori këtë:

V E N D I M

Për anulimin e Konkursit Publik

1. Anulohet vendimi i Komisionit të Auditimit nr. 2/56 të datës 27.07.2023 dhe konkursi i datës 08.08.2023 për pozitën: **Zyrtar për Auditimin e Brendshëm** të NP „Infracos” Sh.A.
2. Obligohet Departamenti i Administratës të bëjë publike anulimin e konkursit në shtypin ditor dhe në ueb faqen e kompanisë
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryesuesi i Komisionit të Auditimit.

ARSYETIM

Në konkursin e datës 08.08.2023 për Zyrtar të Auditimit të Brendshëm, kanë aplikuar pesë kandidatë. Komisioni i Auditimit me datë 12.09.2023, ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm.

Pas shqyrtimit të aplikacioneve Komisioni i Auditimit ka konstatuar se vetëm dy kandidat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe kriteret e parapara me konkurs.

Me nenin 2, paragrafi 2, të Rregullores nr. 2/65 të datës 07.08.2023 për Plotësim Ndryshim e Rregullores së Marrëdhënies së Punës së NP INFRAKOS SH.A me nr. protokollin 2/46 të datës 29.09.2020, shprehimisht është përcaktuar që në konkurset publike për rekrutimin e zyrtarëve të lartë të përcaktuar me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike duhet që së paku tre(3) kandidat të plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit në mënyrë që më pas të vazhdohet me procesin e intervistimit të kandidatëve.

Nga sa u tha me lartë, Komisioni i Auditimit unanimsht vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Gene Hundozi
Kryesuesi i Komisionit të Auditimit

I dërgohet:

- NJPMNP
- Sekretarit të Kompanisë
- Administratës
- Arkivit